



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 79, datë 30.03.2023

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS NR. 111, DATË 27.10.2022 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË APARATIT TË BASHKISË SË DURRËSIT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore; të nenit 5, shkronja “d” të Ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.111, datë 27.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë Durrës”, si më poshtë vijon:

- a) Në pikën 1.1, pika 11 e tabelës “Këshilltar të kryetarit”, paga bazë mujore bëhet 40000 lekë.
- b) Në pikën 1.3, pika 13 e tabelës “Punonjës administrativ të arkivës”, paga bazë mujore bëhet 40000 lekë.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 01.04.2023 dhe do përballohen nga fondet e lira të krijuara si pasojë e vakancave të vitit 2023.
3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 03.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 232 / prot.
5

Durrës, më 06.04 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.79 datë 30.03.2023 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 111, datë 27.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë së Durrësit””.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

